



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË  
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA UNITETI KOMBËTAR, PJESTARE  
E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, të paraqitura nga Partia Uniteti Kombëtar, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Uniteti Kombëtare, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Uniteti Kombëtar, me vendimin e KQZ-së nr. 37, datë 11.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Uniteti Kombëtar.



**Nr. 637 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 11:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Uniteti Kombëtar", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Partia Uniteti Kombëtar, me vendimin e KQZ-së nr. 37, datë 11.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Uniteti Kombëtar.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Tiranë; pasi bashkitë Lezhë, Tiranë, administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, të propozuar nga Partia Uniteti Kombëtar;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës \_\_.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Bashkive: Lezhë, Tiranë të Partisë Uniteti Kombëtar dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezultoi se:

**Bashkia Lezhë, kandidati me nr. 01 Vicens Tuku**, në pikën 4, ka deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Lezhë, për veprën penale të parashikuar nga neni 84, 150 KP, periudha 19.12.2014 – 31.12.2014, pushuar hetimi. Në pikën 5, ka deklaruar masë shtrënguese "arrest me burg" revokuar dhe "detyrim paraqitje" revokuar.

**Bashkia Lezhë, kandidati me nr. 7 Rinev Dunaj**, ka deklaruar se është dënuar nga Gjykata Apelit Tiranë me vendimin nr.2438, datë 19.11.2018, për veprën penale parashikuar nga neni 291 K.P "drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", është dënuar me 2 muaj burgim, ndryshuar me 4 muaj kohe prove.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillin bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezultoi se:



## **Lista shumemërore e Bashkisë Lezhë:**

- 1- Kandidati me numër rendor 07 z. RINEV AVENIR DANAJ,** me vendimin nr.2441 datë 18.07.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e deklaroi fajtor për veprën penale drejtim automjeti në mënyrë të parregullt, parashikuar nën 291 K.P. dhe nën 406 K.PR.P dënohet me 2(dy) muaj burgim. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2438 dt.19.11.2018 vendosi lenien në fuqi të vendimit me ndryshimin në zbatim të nën 59 të K.P. urdherohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për 4-muaj.
- 2- Kandidati me numer rendor 21 z.FRROK NDUE SIMONI** Me vendimin nr.88, dt.14.08.1989 Gjykata e rrethit Gjyqësor Lezhe deklaroi fajtor për krimin e përvetësimit të pasurisë sociale e në bazë të nën 63 të K.Penal e dënonte me 4(kater) muaj heqje lirie.Keshilli Gjyqësor zonal Shkoder në bazë të vendimit nr.97, dt. 28.09.1989 vendosi lenien në fuqi të vendimit nr.88 dt. 14.08.1989 të Gjykatës Rrethit Lezhe Rehabilituar në bazë të nën 69 K.Penal.
- 3- Kandidati me numër rendor 03 z.ARGJONTJANO PJETER NOKA.** Në bazë të vendimit nr. 06. dt. 26.01.2012 Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kruje është deklaruar fajtor për veprën penale drejtim të automjetit pa dëshmi aftësie, e në bazë të nën 291 K.P. dhe nën 406 K.PR.P. dënohet me 40.000 leke gjobe. Gjykata e Apelit me vendim nr.704 dt.29.06.2012 ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.6 dt.26.01.2012 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kruje. Rehabilituar në bazë të nën 69 K.Penal.
- 4. Kandidati me numër rendor 03 z.ARGJONTJANO PJETER NOKA.** Në bazë të vendimit nr. 06. dt. 26.01.2012 Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kruje është deklaruar fajtor për veprën penale drejtim të automjetit pa dëshmi aftësie, e në bazë të nën 291 K.P. dhe nën 406 K.PR.P. dënohet me 40.000 leke gjobe. Gjykata e Apelit me vendim nr.704 dt.29.06.2012 ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.6 dt.26.01.2012 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kruje. Rehabilituar në bazë të nën 69 K.Penal.
- 5. Kandidati me numër rendor 24 z. ANDI SHKËLQIM HYSA.** Me vendim nr. 838, datë 23.3.2015 gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt, e në bazë të nën 291 të kodit Penal dhe nën 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimit me dy muaj burgim në bazë të nën 63 të Kodit penal zëvendësimin me detyrim të përmbushje 80 orë punë me interes publik. Gjykata e Apelit Tiranë me numër 21 datë 11.1.2016 vendosi mospranimin e ankimit. Rehabilituar në bazë të nën 69 të Kodit Penal.
- 6. Kandidati me numër rendor 9 z. Jonida Olldashi.** Me vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale të fyerjes parashikuar nga nën 119/2 i kodit penal dënohet me 50 000 lekë gjobë. Rehabilituar në bazë të nën 69 Kodi penal.
- 7. Kandidati me numër rendor 27, z. Luljeta Pajolli .** Me vendim nr.65, datë 29.6.1989 gjykata e rrethit gjyqësor Lushnje e deklaroi fajtor për goditje të personit për shkak të detyrës e në bazë të nën 119, 31 të kodit penal është dënuar me 3 muaj riedukim ndërmjet punës duke ju ndaluar 1/6 e të ardhurave mujore. Rehabilituar në bazë të nën 69 të Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat



e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga Partia Uniteti Kombëtar dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, të Partisë Uniteti Kombëtar, pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

